



Këshilli Ekonomik dhe Social

Shpërndarja: E kufizuar
9 korrik 2021

Originali: Në gjuhën angleze
I disponueshëm në gjuhët angleze,
frënge dhe spanjolle

Përkthimi i dokumentit është jo
zyrtar dhe terminologjia e përdorur
nuk reflekton domosdoshmërisht
atë të Kombeve të Bashkuara.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Bordi Ekzekutiv

Sesioni i dytë i rregullt i vitit 2021

7-10 shtator 2021

Pika 6 (a) e rendit të përkohshëm të ditës*

Dokumenti i programit për vendin

Shqipëri

Përmbledhje

Dokumenti i programit për Shqipërinë i paraqitet Bordit Ekzekutiv për diskutim dhe miratim në këtë seancë, mbi bazën se për të nuk ka kundërshtime. Dokumenti i programit përfshin propozimin për një buxhet agregat indikativ prej 4,250,000 USD nga burimet e rregullta, në varësi të disponueshmërisë së fondeve, dhe 20,000,000 USD nga burime të tjera, në varësi të disponueshmërisë së kontributeve për qëllime të posaçme për periudhën 2022 deri 2026.

* [E/ICEF/2021/23](#).

Shënim: Përpunimi i këtij dokumenti u krye tërësisht nga UNICEF-i.

Shënim: Të gjitha të dhënat në faqen e korrigjimeve në versionin anglisht janë reflektuar saktësisht në versionin e përkthyer në gjuhën shqipe.

Arsyetimi i programit

1. Megjithëse kohët e fundit Shqipëria ka fituar statusin e vendit me të ardhura të mesme të larta, ajo ende mbetet një prej vendeve më të varfra në Evropë. Në Shqipëri po zbatohen reforma të rëndësishme që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian dhe rigjallërimin e rritjes ekonomike. Për dhjetë vjet, ekonomia është rritur me 2-5% për qind çdo vit.¹ Në vitin 2021, popullsia e Shqipërisë është vlerësuar në shifrën 2,83 milion banorë, ku përfshihen afërsisht 300,000 vajza dhe 315,000 djem. Popullsia ka pësuar rënie që prej vitit 2001, kryesisht për shkak të emigracionit dhe rënies së numrit të lindjeve.²

2. Kërkohet një rritje e mëtejshme e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe financiare për mbrojtjen në vijimësi të të drejtave të fëmijëve dhe për t'iu përgjigjur pasojave social-ekonomike të pandemisë së koronavirusit 2019 (KOVID-19). Jeta e fëmijëve është ndikuar në shumë mënyra si rezultat i mbylljes së shkollave, izolimit, të ardhurave më të pakta familjare dhe privimeve jomonetare. Gratë dhe vajzat rrezikojnë të përballen me më shumë dhunë me bazë gjinore, vështirësi ekonomike, me ngarkesë më të madhe të kujdesit për të tjerët, përkeqësim të shëndetit dhe mirëqenies emocionale dhe më pak akses në shërbimet shëndetësore. Më të prekurat janë vajzat dhe gratë nga zonat rurale, komunitetet rome dhe egjiptiane dhe ato me aftësi të kufizuara. Pakësimi i të ardhurave të shtetit shkaktuar nga KOVID-19 mund të sjellë reduktim të shpenzimeve për fëmijët.

3. Është e nevojshme të bëhen përpjekje më të mëdha në nivel kombëtar për t'iu përgjigjur rreziqeve mjedisore – ndryshimeve klimatike, shpyllëzimit, erozionit të tokës, ndotjes së ujit, tërmeteve, përmbytjeve dhe thatësirave. Në Indeks të Performancës Mjedisore 2020, Shqipëria kishte renditje të dobët për sa i përket cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbeturinave, ndryshimeve klimatike dhe burimeve ujore.

4. Ndër fëmijët dhe adoleshentët që rrezikohen më së tepërmi të mbeten mbrapa përfshihen ata nga familjet me të ardhura të ulëta ose familjet me një prind (sidomos femrat), vajzat, fëmijët dhe adoleshentët nga komunitetet rome dhe egjiptiane, ata me aftësi të kufizuara, ata nga komunitetet e thella rurale, si dhe ata që kanë ardhur në Shqipëri si refugjatë dhe emigrantë përmes lëvizjeve të përziera të popullsisë, ndër të cilët edhe fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë nga familja dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Me gjithë ekzistencën e një kuadri të fuqishëm institucional për barazinë gjinore, qasja e grave dhe vajzave në arsim, tregje, burime dhe në proceset e vendimmarrjes mbetet e kufizuar dhe gratë përballen me stereotipizime negative, diskriminim me bazë gjinore, si dhe me rrezikun e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.³

5. Ndonëse i ka ratifikuar instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Shqipëria nuk bën monitorim sistematik të të drejtave të fëmijëve. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), ministritë e linjës, bashkitë dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut nuk kanë burime për të gjeneruar të dhëna dhe për të bërë analiza lidhur me mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve,⁴ çka është një mundësi e humbur për t'i përdorur këto instrumente në shërbim të një vendimmarrjeje efektive.

¹ Shifra të Bankës Botërore, 2009–2019..

² Instituti i Statistikave Shqipëri (INSTAT), vlerësime të popullsisë së Shqipërisë më 1 janar 2021.

³ Kombet e Bashkuara, *Albania: Common Country Analysis 2020* (Shqipëria: Analizë e përbashkët për vendin 2020); dhe UNICEF Shqipëri, *Situation Analysis of Children in Albania 2020* (Analizë e situatës së fëmijëve në Shqipëri 2020).

⁴ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Raport i zbatimit të agjendës kombëtare për të

6. Ndërmjet viteve 2012 dhe 2019, shkalla absolute e varfërisë u ul nga 39,1 për qind në 35,5 për qind, por përsëri mbetet më e larta ndër vendet e Ballkanit Perëndimor.⁵ Sipas Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2018, pothuaj një e katërta e shqiptarëve ishin të rrezikuar nga varfëria, krahasuar 16,9 për qind që ishte mesatarja në Bashkimin Evropian. Rreth një e treta e personave të rrezikuar ishin fëmijë. KOVID-19 dhe tërmeti i vitit 2019 e përkeqësuan gjendjen e familjeve dhe përkeqësuan varfërinë që sipas vlerësimeve të Bankës Botërore parashikohej të arrinte deri në 40-44 për qind në pranverën e vitit 2021. Sistemi i mbrojtjes sociale i shtjelluar në politika nuk zbatohet në mënyrë adekuate. Shpenzimet për ndihmën ekonomike për familjet dhe fëmijët janë të ulëta; edhe më të ulëta janë shpenzimet për shërbimet e kujdesit shoqëror: në të gjitha institucionet kombëtare dhe vendore të mbrojtjes sociale burimet financiare janë të pamjaftueshme.

7. Krahasuar me 20 vjet më parë, në Shqipëri vdesin më pak fëmijë përpara se të mbushin pesë vjeç, megjithëse vdekshmëria foshnjore dhe vdekshmëria e fëmijëve deri në pesë vjeç pësoi një farë rritjeje në periudhën 2016–2020,⁶ ku fëmijët nga disa zona të caktuara dhe nga komunitetet rome dhe egjiptiane janë më të rrezikuar se të tjerët. Foshnjat përballen me rrezikun e trefishtë të prapambetjes në zhvillimin trupor (stunting), mbipeshës dhe anemisë. Vetëm 57 për qind e foshnjave ushqehen me gji brenda një ore pas lindjes dhe vetëm 29 për qind e fëmijëve të moshës 6 deri në 23 muajsh ushqehen me dietën minimale të pranueshme. Ndonëse sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor (SDH) 2017–2018, në periudhën 2017–2018 shkalla e vaksinimit të fëmijëve të moshës 12 deri në 23 muajsh ishte 96 për qind ose më e lartë, vetëm 79 për qind e tyre kanë bërë vaksinën që përmban mbrojtjen kundër fruthit. Mungon referimi në një sistem të nivelit më të lartë për monitorimin e zhvillimit të fëmijës, zbulimin e rreziqeve të hershme dhe menaxhimin e problemeve në zhvillimin e fëmijës, dhe shërbime sistematike që mundwsojnw arsimimin përfshirës të fëmijëve zhvillimi i të cilëve është i rrezikuar ose i penguar.

8. Tetëdhjetë për qind e fëmijëve të moshës 3 deri në 6 vjeç ndjekin arsimin parashkollor, por fëmijët nga familjet e pafavorizuara shpesh janë të përjashtuar nga ky arsim për shkak të kostove jo të drejtpërdrejta, vendndodhjes gjeografike dhe stigmës për shkak të aftësisë së kufizuar dhe prejardhjes etnike. Ndonëse ndjekja e arsimit parashkollor nga fëmijët romë është rritur gjatë viteve të fundit, ajo përsëri mbetet vetëm në nivelin 35 për qind.⁷ Standardet dhe kurrikulat mësimore për nivelin parashkollor janë përmirësuar, por programet e arsimit parashkollor ende nuk e vënë theksin në rolin edukativ të lojës. Aftësia për lexim dhe shkrim është pothuaj universale, por niveli i aftësisë për lexim dhe shkrim tek femrat ende është 2,3 pikë për qindjeje më i ulët se tek meshkujt.⁸ Sipas SDH-së, gjatë periudhës 2017-2018, rreth 25 për qind e vajzave dhe grave të moshës mbi 6 vjeç nuk e kishin përfunduar arsimin fillor, krahasuar me 23 për qind të meshkujve.

9. Ndonëse rezultatet mësimore në shkolla janë përmirësuar si rezultat i reformave në arsim dhe zbatimit të një kurrikulumi bazuar në kompetenca, shumë nxënës largohen nga shkolla pa pasur kompetencat bazë dhe vetëm 2 për qind e tyre kanë zhvilluar aftësi të rendit më të lartë kur arrijnë moshën 15 vjeç, sipas raportit më të

drejtat e fëmijëve 2021–2026”

⁵ Banka Botërore, *Western Balkans Regular Economic Report: Spring 2019* (Raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor: pranverë 2019).

⁶ Grupi Interinstitucional i Kombeve të Bashkuara për Vlerësimin e Vdekshmërisë Foshnjore për periudhën 2016–2020.

⁷ Banka Botërore, *Bashkimi Evropian dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Anketa Rajonale për Romët*, 2017.

⁸ INSTAT, 2019.

fundit të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.⁹ Megjithëse numri i vajzave që mbarojnë studimet në nivelet e larta është mjaft më i madh se i djemve, vetëm 15 për qind e vajzave u diplomuan në degë si shkenca, teknologji, inxhinieri ose matematikë në vitin 2018. Në vitin 2019, 25,3 për qind e të rejave dhe 25,8 për qind e të rinjve të moshës 15 deri 24 vjeç nuk ishin në punësim, arsim ose trajnim.¹⁰ Stereotipet gjinore ndikojnë në arsimim dhe në pjesëmarrjen në tregun e punës. Pavarësisht se qasja e fëmijëve romë në arsim në klasat 1-9 është rritur në 66 për qind, rezultatet arsimore të atij grupi mbeten ndër më të ulëtat në Shqipëri.¹¹ Në bazë të raportimit të PISA-s për vitin 2018, rreth 60 për qind e nxënësve ishin analfabetë funksionalë, duke e renditur Shqipërinë në vendin e 61-të nga 78 vendet në të cilat u krye vlerësimi. Krahasuar me shkollat në zonat rurale, shkollat e qyteteve kanë numër më të madh dhe cilësi më të lartë të personelit mësimor dhe një cilësi më të lartë arsimimi.

10. Përmbajtja e dokumenteve qeveritare dëshmon për ekzistencën e vetëdijes për nevojat e adoleshentëve, megjithatë të gjitha shërbimet miqësore ndaj adoleshentëve të cilat funksiononin më parë tashmë kanë pushuar së funksionuari.¹² Në trajtimin e adoleshentëve, sistemi i shërbimeve shëndetësore fokusohet përgjithësisht në shëndetin e tyre fizik dhe jo në forcimin e rezilencës, aftësive për përballimin e situatave dhe vetëbesimit të tyre. Kërkimi i këshillave shëndetësore, veçanërisht në lidhje me shëndetin mendor, gjeneron stigmë dhe diskriminim. Mbështetja e prindërve për shëndetin e fëmijëve adoleshentë është e pamjaftueshme. Një numër në rritje i adoleshentëve janë mbi peshë për shkak të mjediseve me ushqim të pashëndetshëm, reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme, informacionit të pamjaftueshëm në etiketat e mallrave ushqimore dhe njohurive të pakta të prindërve dhe adoleshentëve në lidhje me ushqyerjen.

11. Në një anketë të organizatës “Save the Children” të vitit 2017, fëmijët dhe adoleshentët theksuan se prindërit dhe institucionet duhet t’i dëgjojnë më shumë ata dhe të angazhohen më shumë me shqetësimet e tyre. Më të përjashtuarit nga pjesëmarrja në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre janë adoleshentët me aftësi të kufizuara, vajzat, ata nga komunitetet rome dhe egjiptiane dhe ata që jetojnë në zona rurale dhe të thella. Modelet ose mekanizmat ekzistuese qeveritare të pjesëmarrjes përforcojnë praktikën e pabarazisë dhe përjashtimit.

12. Në vitin 2019, rreth 700 fëmijë jetonin në institucione rezidenciale, nga të cilët shumica ishin fëmijë romë dhe me aftësi të kufizuara. Prindërit biologjikë të rreth dy të tretave të fëmijëve të institucionalizuar ishin gjallë; pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve ishin ndarë nga familjet për shkak të varfërisë. Rreth 70 për qind e fëmijëve nën përkujdesje shfaqnin shenja të problemeve zhvillimore.¹³ Mungesa pothuaj e plotë e zbulimit dhe identifikimit të hershëm të cenueshmërive dhe vështirësive familjare bën që të ketë kaq shumë ndarje të fëmijëve nga familja. Sistemi i parandalimit të ndarjes së fëmijëve nuk është i përcaktuar qartë dhe personeli nuk ka burime të mjaftueshme. Ndihma në para e kombinuar me mbështetjen në shërbime nuk është kudo e disponueshme për të forcuar familjen apo mbështetur kundesin e

⁹ Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) PISA “*Results in Focus—Albania*” (Rezultate në fokus - Shqipëria), 2018.

¹⁰ INSTAT, *Anketa e forcave të punës*, 2019.

¹¹ OECD PISA, “*Results in Focus – Albania*” (Rezultatet në fokus - Shqipëria), 2018.

¹² Organizata Botërore e Shëndetësisë, *Assessment of sexual, reproductive, maternal, newborn, child and adolescent health in the context of universal health coverage in Albania* (Vlerësim i shëndetit seksual, riprodhues, të nënave, foshnjave të porsalindura, fëmijëve dhe adoleshentëve në kontekstin e mbulimit shëndetësor universal në Shqipëri), 2020.

¹³ Plani Kombëtar për Deinstitutionalizimin e Fëmijëve në Shqipëri.

fëmijëve prej të afërmeve. Shërbimet alternative me bazë komunitetin ose mungojnë plotësisht, ose janë të pamjaftueshme.

13. Dhuna ndaj fëmijëve në mjediset e shtëpisë, shkollës, komunitetit si dhe në internet paraqitet në forma të ndryshme. Rreth 61 për qind e të gjitha rasteve të abuzimit seksual kanë të bëjnë me fëmijë.¹⁴ Vlerësohet se rreth 48 për qind e fëmijëve të moshave 2 deri në 14 vjeç kanë përjetuar më së paku një formë të agresionit psikologjik ose fizik,¹⁵ dhe 33,9 për qind (shumica djem) ishin përfshirë në grindje fizike të paktën një herë gjatë vitit të kaluar. Sipas studimit mbi sjelljet shëndetësore tek fëmijët e moshës shkollore 2017-2018, 22 për qind e fëmijëve raportuan se kishin përjetuar bullizëm në shkollë dhe 83 për qind e fëmijëve në shkollë të moshave 11, 13 dhe 15 vjeç raportuan se kishin përjetuar forma të ndryshme të dhunës. Abuzimet në internet janë shumë të përhapura. Çdo vit punonjësit e agjencive ligjzbatuese ndërkombëtare i referojnë policisë shqiptare midis 5,000 dhe 20,000 raste materiale të publikuara në internet ku tregohet abuzim seksual i fëmijëve. Megjithatë, gjatë tre viteve u kryen hetime vetëm në lidhje me 12 raste, nga të cilat vetëm një prej tyre u zbulua me sukses.¹⁶ Një ndër dhjetë fëmijë ka raportuar se ka pasur të paktën një përvojë të padëshiruar seksuale në internet, shumica të iniciuara nga persona të njohur prej tyre.¹⁷ Pranimi i situatës dhe kultura e mohimit e bëjnë të vështirë trajtimin e problemit të dhunës dhe shumë prindër ende mendojnë se përdorimi i dhunës fizike ndaj fëmijëve është i justifikuar.

14. Po kështu, edhe dhuna me bazë gjinore është gjerësisht e përhapur dhe e pranuar. Sipas vërtetimit kombëtar me bazë popullatën “Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri 2018” të Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) 52,9 për qind e grave kishin përjetuar një ose më shumë forma të dhunës gjatë jetës.

15. Në periudhën 2017-2018, 11 për qind e grave dhe 2 për qind e burrave të moshës 20 deri 49 vjeç ishin martuar para se të mbushnin 18 vjeç and 3,5 e femrave të moshës 15 deri 19 vjeç kishin filluar shtatzënitë, krahasuar me 2,8 për qind e tyre në periudhën 2008-2009.¹⁸ Parapëlqimi për martesë në moshë të mitur – sidomos në radhët e romëve – i ka rrënjët thellë në normat sociale, bindjet personale dhe varfërinë e thellë.¹⁹

16. Rreth 17,500 fëmijë ndërveprojnë çdo vit me një sistem drejtësie që nuk është miqësor ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve. Konteksti në të cilin funksionon sistemi karakterizohet nga pabarazia sociale dhe vlerësimi i pamjaftueshëm i rrethanave shoqërore. Numrin më të madh të atyre që nuk kanë akses në drejtësi e përbëjnë vajzat, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët nga familje të varfra dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

17. Programi i bashkëpunimit për vitet 2022–2026 do të trajtojë mësimet e identifikuar gjatë vlerësimit të programit të UNICEF-it për Shqipërinë për vitet 2017–2021:

(a) Përdorimi i qasjes së ciklit të jetës do të bëjë të rrisë koherencën e programimit përmes punës ndërsektoriale;

(b) Financimet publike për fëmijët dhe shtimi i monitorimit të shërbimeve do të mbështesin decentralizimin në vijimësi të shërbimeve;

¹⁴ INSTAT, Statistikat e krimeve dhe të drejtësisë penale, 2018.

¹⁵ Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri (2017-2018).

¹⁶ UNICEF Shqipëri, *Rastet e humbura*, 2020.

¹⁷ UNICEF Shqipëri, *Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri*, 2019.

¹⁸ ADHS 2017–2018.

¹⁹ UNICEF dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, *Njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet për martesat e fëmijëve në komunitetet e prekura në Shqipëri*, 2018.

(c) Theksimi i programimit me ndjeshmëri gjinore në secilin rezultat, trajtimi i normave gjinore në komunikimet lidhur me ndërhyrjet zhvillimore në disa rezultate, dhe formulimi i rezultateve me fokus të posaçëm gjinor do sigurojnë përfshirjen e prioritetëve për barazinë gjinore dhe të këndvështrimit gjinor.

Prioritetet e programit dhe partneritetet

18. Programi i UNICEF-it për Shqipërinë ka një vizion madhor: të gjithë fëmijët do të gëzojnë të drejtat e tyre të plota, që garantohen nga institucione të përgjegjshme, përfshirëse dhe transparente dhe nga familje dhe komunitete që u ofrojnë kujdes të gjithanshëm dhe mbrojtje dhe që nxisin pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre. Për të arritur këtë, programi i Shqipërisë përmban komponentë për fëmijët e vegjël; fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët; mbrojtjen e fëmijëve; dhe mjedisin mundësues.

19. Programi i Shqipërisë është harmonizuar me prioritetet kombëtare të zhvillimit, ndër të cilat Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, (2021–2030), Draft-Strategjia e Tretë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022–2030), Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë (2021–2025), Strategjia Kombëtare e Arsimit (2021–2026), Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin (2020–2022), Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me aftësi të Kufizuara (2021–2025) dhe Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (2020–2025). Programi do të mbështesë zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventën mbi të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe rekomandimet e Shqyrtimit Periodik Universal dhe do të mbështesë arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

20. UNICEF-i do të mbështesë në vijimësi procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, do të krijojë partneritete për *acquis* të Bashkimit Evropian dhe do të mbështesë Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës.

21. Programi dhe politikat e tij do të shtrihen në të gjithë vendin, do të mbështesin proceset e decentralizimit dhe do t'i bëjnë më efektive strukturat vendore për fëmijët, sidomos në zonat rurale dhe ato më të varfra.

22. Partneriteti me agjencitë e Kombeve të Bashkuara do të vazhdojë të arrijë rezultate të mtejshme për fëmijët. Programi i Shqipërisë është harmonizuar me Kornizën e Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim të Qëndrueshëm (KBZHQB) 2022–2026. UNICEF-i do të krijojë partneritete me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara për përparimin e të drejtave të fëmijëve dhe mund të përfshihet në programime të përbashkëta në fushat e shërbimeve sociale cilësore, të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut, drejtësisë, aftësive të kufizuara, reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike, çështjeve të të rinjve/adoleshentëve, migracionit dhe dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.

23. UNICEF-i do të trajtojë gjithashtu problemet madhore që lidhen me pabarazinë, përjashtimin dhe marginalizimin e fëmijëve më të rrezikuar, dhe do të promovojë përfshirjen dhe kohezionin social.

24. UNICEF-i do të shtojë pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve dhe të rejave në nismat nënrajonale dhe do të sigurojë që të gjithë fëmijët të zhvillojnë potencialin e tyre më të plotë nëpërmjet komunikimit, veprimtaritë e avokacisë, ndërtimin e partneriteteve dhe angazhimin programatik.

25. UNICEF-i do të zgjerojë strategjinë për mobilizimin e burimeve për të eksploruar mundësitë e mbështetjes nga donatorë të rinj dhe do të nxisë mobilizimin e burimeve të sektorit privat. Ai do të zhvillojë më tej bashkëpunimin ndërkuftar, sidomos në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

26. Programi i Shqipërisë zbaton qasjen e ciklit të jetës në mobilizimin e aktorëve të shumtë rreth dritareve të mundësive për grupmoshat kritike, me synim përparimin në tërësi të të drejtave të fëmijëve. Do të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për mbështetjen e barazisë gjinore, në përputhje me Planin e Veprimit të Barazisë Gjinore të UNICEF-it.

Fëmijët e vegjël

27. Ky komponent synon të sigurojë që fëmijët më të cenueshëm, qoftë djem apo vajza, si dhe prindërit dhe kujdestarët e tyre, të kërkojnë, të kenë akses dhe të përdorin shërbime cilësore shëndetësore, të arsimit parashkollor dhe të zhvillimit të fëmijëve.

28. UNICEF-i do të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të rritur kapacitetet e sistemit të shërbimit shëndetësor, për të ofruar shërbime adekuate shëndetësore dhe të ushqyerjes për nënat, foshnjat e porsalindura dhe fëmijët, duke u fokusuar në zbulimin e hershëm të problemeve zhvillimore dhe në ndërhyrjet e hershme. UNICEF-i do të punojë në partneritet me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe Bankën Botërore për të gjeneruar të dhëna lidhur me vdekshmërinë e foshnjave të porsalindura dhe do të kryejë avokaci të bazuar në të dhëna për të mbështetur politika dhe masa fiskale për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së foshnjave të porsalindura.

29. UNICEF-i do të kontribuojë për zbulimin në kohë të problemeve të zhvillimit gjatë viteve të para të jetës dhe kapërcimin e tyre, si dhe për një cilësi më të mirë të shërbimeve për fëmijët e vegjël. Kjo do të bëhet nëpërmjet: mbështetjes për përditësimin e standardeve të përkujdesit; hartimit të udhëzuesve dhe protokolleve të mbështetura në të dhëna lidhur me kujdesin me bazë familjen; mbështetjes së monitorimit të zhvillimit të fëmijëve dhe identifikimit dhe referimit të hershëm të rreziqeve; krijimit të modeleve të ndërhyrjes dhe rritjes së kapaciteteve të punonjësve në fushën e shëndetësisë; dhe mbështetjes teknike të ndjekjes në vijimësi të të porsalindurve të rrezikuar.

30. Gjithashtu, UNICEF-i do të bëjë avokaci për përfshirjen e ushqyerjes së fëmijëve në strategjinë e re të sektorit shëndetësor dhe në strategjinë e re për sëmundjet jongsjellëse.

31. Do të ketë angazhim me familjet dhe komunitetet për përmirësimin e aftësive dhe sjelljeve prindërore për të ofruar kujdes për zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës. Këtu do të përfshihet edhe puna për trajtimin e çështjeve si hezitimi për të vaksinuar fëmijët dhe shoqërizimi gjinor që në fëmijërinë e hershme, si dhe normat e stereotipit e dëmshme që ndikojnë në rezultatet e vajzave dhe djemve në jetë.

32. UNICEF-i do të mbështesë Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë për të gjeneruar të dhëna dhe për të mbështetur ndjekjen nga të gjithë fëmijët të vitit parashkollor, me synimin për të ndihmuar fëmijët më të cenueshëm të mbetur prapa. Me ndihmën e UNICEF-it, disa bashki do të shtojnë kapacitetet e tyre teknike të planifikimit dhe buxhetimit për mbështetjen e një arsimit parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe për të dhënë shembuj të praktikës së mirë. Shoqatat e prindërve do të aftësohen të ngrenë zërin për të kërkuar një arsim parashkollor cilësor.

Fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët

33. Në kuadër të këtij komponenti, djemtë dhe vajzat e moshës shkollore dhe adoleshentët do të përfitojnë nga një mjedis i shëndetshëm, i qëndrueshëm dhe me ndjeshmëri ndaj nevojave gjinore që u mundëson të mësojnë dhe të fitojnë aftësi për jetën, si dhe për të kërkuar, për të pasur akses në shërbimet përkatëse dhe për t'i përdorur ato.

34. UNICEF-i do të punojë për shërbime arsimore cilësore, të ndjeshme ndaj nevojave gjinore, që mbështesin aksesin për të gjithë dhe që përfshijnë novacione dhe reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. UNICEF-i do të mbështesë financimin përmes formulave të bazuara në parimet e barazisë, duke u mundësuar shkollave që të arsimojnë fëmijët e cenueshëm. Zhvillimi i kapaciteteve teknike do të mundësojë krijimin e një sistemi për identifikimin e hershëm të cenueshmërive të fëmijëve dhe për të mbështetur më shumë fëmijë që të vazhdojnë shkollën, sidomos vajzat nga komunitetet e pakicave. UNICEF-i do të mbështesë sistemet e mësimdhënies dhe të nxënies në internet dhe do të ndihmojë ndërtimin e kapaciteteve për realizimin e një kurrikulumit bazuar në kompetenca dhe për të rritur kapacitetet për hartimin dhe zbatimin e planeve për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë.

35. Së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, UNICEF-i do të fuqizojë vajzat dhe djemtë adoleshentë duke i pajisur me më shumë njohuri dhe aftësi për një ushqyerje më të shëndetshme, për të shmangur mbipeshën dhe obezitetin. UNICEF-i do të punojë në partneritet me aktorë të ndryshëm, me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe OBSH-në për të trajtuar shqetësimet shëndetësore të adoleshentëve në shkollë, komunitet dhe platforma digjitale. Kjo do të përfshijë edhe promovimin e shëndetit mendor, të sjelljeve të shëndetshme, si dhe parandalimin e sëmundjeve të shëndetit mendor.

36. Së bashku me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, UNICEF-i do të mbështesë mundësitë institucionale dhe jointucionale për të pajisur të rinjtë me aftësitë që nevojiten në shekullin e njëzetentjetë, duke u fokusuar në aftësitë për jetën, aftësitë sipërmarrëse, njohuritë mbi mediat dhe njohuritë kompjuterike. UNICEF-i do të angazhojë gjithashtu edhe sektorin privat për të mobilizuar të rinjtë e të rejtat, për të mbështetur platformat pjesëmarrëse dhe fuqizimin, si dhe për të investuar në fushën e zhvillimit të aftësive. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet vajzave nga komunitetet e marginalizuara. UNICEF-i do të mbështesë gjithashtu edhe zgjerimin dhe përdorimin e platformës U-Raport për monitorimin e cilësisë së shërbimeve dhe për angazhimin e rinisë në vendimmarrje.

Mbrojtja e fëmijëve

37. Ky komponent synon që të sigurojë që fëmijët më të cenueshëm të mbrohen nga dhuna dhe varfëria dhe të përdorin shërbimet shoqërore dhe ato për mbrojtjen e fëmijëve.

38. Për të ulur numrin e fëmijëve në kujdes institucional, UNICEF-i do të mbështesë rishikimin e kornizës ligjore dhe rregullatore lidhur me strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe do të nxisë krijimin e një sistemi të financuar në mënyrë adekuate që nxit bashkimin e fëmijëve me familjen. UNICEF-i do të ofrojë mbështetje teknike për ndërtimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për fëmijët në kujdesin alternativ. Së fundi, në nivel vendor, UNICEF-i do të mbështesë krijimin e modeleve dhe përshkallëzimin e shërbimeve alternative cilësore, përfshirë edhe shërbimin profesional të kujdestarisë në raste emergjencash.

39. UNICEF-i dhe partnerët e tij do të hartojnë të dhëna mbi varfërinë shumëdimensionale të fëmijëve dhe benefitet e mbrojtjes shoqërore. Ligje të ndryshme që rregullojnë pagesat e ndihmës ekonomike do të harmonizohen për të siguruar që sistemi i mbrojtjes shoqërore të mund të përballojë goditjet/shokun dhe të ofrojë ndihmë ekonomike dhe të kujdesit për fëmijët e cenueshëm, ndër të cilat edhe për vajzat adoleshente më të marginalizuara. Ky sistem i aftë për të përballuar goditjet do t'i ndihmojë familjet të përballojnë KOVID-19 dhe emergjenca të tjera. UNICEF-i do të mbështesë zhvillimin e një tërësie shërbimesh të integruara që u përgjigjen nevojave të familjeve të cenueshme. UNICEF-i do të ndihmojë në

zhvillimin e një sistemi për garantimin e cilësisë të punës sociale dhe për të vënë në provë një paketë të integruar shërbimesh që lidhen me programet e pagesave të ndihmës ekonomike.

40. Për të siguruar realizimin e shërbimeve të integruara për mbrojtjen e fëmijëve për të mbijetuarit e dhunës (përfshirë edhe të dhunës me bazë gjinore), abuzimit dhe shfrytëzimit, UNICEF-i do të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë dhe bashkitë që të sigurojnë që kuadri normativ për mbrojtjen e fëmijëve të përmbushë standardet ndërkombëtare. Organet qeveritare do të mbledhin, analizojnë dhe përdorin sistematikisht të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me dhunën, abuzimin dhe shfrytëzimin e tyre. Organet kryesore përgjegjëse dhe partnerët e shoqërisë civile do të forcojnë mekanizmat e raportimit mbi dhunën ndaj fëmijëve. UNICEF-i do të punojë për rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve lidhur me përdorimin e sigurtë të internetit nga fëmijët dhe adoleshentët përmes forcimit të kurrikulave sektoriale dhe ofrimit të moduleve shumëdisiplinore për ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë dhe atyre të fushës së mbrojtjes së fëmijëve nga institucionet që ofrojnë trajnime në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

41. UNICEF-i do të kërkojë në mënyrë proaktive vendosjen e një bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërinstitucional me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin për t'iu përgjigjur nevojave dhe cenueshmërive të veçanta të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë nga familja që arrijnë në Shqipëri në kuadër të lëvizjeve të përziera të refugjatëve dhe emigrantëve.

42. Së fundi, institucionet ligjvënëse dhe ato të drejtësisë do të zhvillojnë kapacitetet dhe mjetet për përmirësimin e mëtejshëm të kornizave ligjore dhe politike të drejtësisë për fëmijët, do të përcaktojnë se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijëve dhe do të ofrojnë shërbime të drejtësisë gjithëpërfshirëse dhe miqësore ndaj fëmijëve, përfshirë edhe ato për dhunën me bazë gjinore. UNICEF-i do të mbështesë përmirësimet në sistemin e të dhënave për drejtësinë për fëmijët dhe do të bëjë avokaci për caktimin e profesionistëve për t'u marrë me proceset ligjore që kanë ndikim tek fëmijët. UNICEF-i do të bëjë avokaci për asistencë ligjore falas, do të ndihmojë qeverinë për të rritur besimin e fëmijëve dhe të komuniteteve në sistemin e drejtësisë, do të theksojë statusin e fëmijëve si persona me të drejta, do t'i kundërvihet disa normave patriarkale që i shtyjnë fëmijët drejt kriminalitetit, dhe do të promovojë rehabilitimin në fushën e drejtësisë për fëmijët.

Mjedisi mundësues

43. Ky përbërës ka për qëllim krijimin e një mjedisi që mundëson menaxhimin e politikave dhe të drejtave të fëmijëve, me fokus mbi barazinë, llogaridhënien dhe ndryshimet në normat sociale dhe gjinore.

44. Autoriteteve kombëtare dhe vendore do t'u ofrohet ndihmë teknike për rritjen e kapaciteteve për planifikimin, gjenerimin, përdorimin dhe raportimin efektiv mbi buxhetet e sektorit social dhe për të mobilizuar burimet e duhura të brendshme dhe të jashtme për investime të barabarta me fokus fëmijët.

45. UNICEF-i dhe qeveria do të sigurojnë që angazhimet e Shqipërisë për të drejtat e fëmijëve dhe barazinë gjinore të kenë përparësi në planifikimet kombëtare dhe të mbështeten në përdorimin e të dhënave dhe analizave në dobi të fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve më të marginalizuar, të pakicave, dhe të personave në situata humanitare. UNICEF-i do të punojë me ministrinë e linjës dhe INSTAT-in për të forcuar dhe zgjeruar sistemet e të dhënave administrative. Po zhvillohen diskutime për raundin e ardhshëm të anketës së grupimeve të treguesve të shumëfishtë, në mbështetje të monitorimit të realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

46. UNICEF-i do të ndihmojë Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF-në, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe disa bashki të caktuara, për forcimin e sistemeve të tyre të planifikimit, monitorimit dhe të raportimit në bazë të mandatit të tyre të bashkërendimit ndërsektorial për fëmijët dhe adoleshentët.

47. UNICEF-i do të mbështesë institucionet e mbikëqyrjes publike për garantimin e llogaridhënies për shkeljet e të drejtave të fëmijëve, promovimin e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve dhe për të kërkuar dhe ofruar masa ndreqëse në rast të shkeljes së të drejtave.

48. Së fundi, UNICEF-i do të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe autoritete të tjera, si dhe do të punojë me UNFPA-në, Njësinë e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) dhe anëtarë të tjerë të Grupit Tematik të Kombeve të Bashkuara për Rezultatet Gjinore, për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për barazinë gjinore dhe do të kontribuojë në ndryshimin e normave gjinore, veçanërisht përmes fuqizimit të vajzave adoleshente nga pakicat e marginalizuara, që ato të vlerësohen barabar me djemtë nga familjet dhe komunitetet e tyre. UNICEF-i do të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe organe të tjera për të luftuar dhe parandaluar martesat e hershme dhe për t'u angazhuar me prindërit, adoleshentët dhe komunitetet për të ndryshuar normat dhe stereotipet dhe normat e dëmshme sociale gjinore.

Efektiviteti i programit

49. Bashkërendimi dhe zbatimi i programit do të realizohet përmes një menaxhimi të bazuar në rezultate, duke u mbështetur në qasje ndërsektoriale në të gjitha fushat kryesore, përfshirë programimin e informuar nga rreziqet, dhe gatishmërinë për rastet e emergjencës. Programi do të mbështesë vizionin madhor që të gjithë fëmijët do të gëzojnë të drejtat e tyre të plota, të garantuara nga institucione të përgjegjshme, përfshirëse dhe transparente dhe nga familje dhe komunitete që u ofrojnë kujdes të gjithanshëm dhe mbrojtje, dhe që promovojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre.

50. Për ta arritur këtë, programi do t'i japë përparësi çështjeve ndërsektoriale të varfërisë, aftësive të kufizuara, veprimeve kundër ndryshimeve klimatike, zhvillimit dhe arsimit të fëmijëve të moshës parashkollore, promovimit të mirëqenies dhe pjesëmarrjes së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe reduktimit të dhunës, abuzimit, dhe normave dhe praktikave të dëmshme shoqërore. Vëmendje më e madhe do t'i kushtohet integritetit dhe llogaridhënies për përfshirjen e programimit të përgjigjshëm gjinor. Gjenerimi i të dhënave dhe analizave cilësore do të shërbejnë për të forcuar vendimmarrjen në nivel qeveritar, komunikimin e programit, mbledhjen e fondeve dhe aleancat me sektorin privat, partneritetet me agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara dhe mbështetjen e publikut.

51. UNICEF-i do të vazhdojë të arrijë rezultate më të larta për fëmijët përmes kuadrit të bashkëpunimit të Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë. Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra deri më sot, do të shihen mundësitë për programe të përbashkëta për avokaci në mbarë sistemin, dialog mbi politikën, dhe për çështje të zbatimit për rastet komplekse. Plani i rimëkëmbjes social-ekonomike i Kombeve të Bashkuara pas pandemisë së KOVID-19 po mbështet qeverinë, dhe UNICEF-i do të forcojë rolin e tij për të siguruar që vendi të jetë i përgatitur dhe i gatshëm për përballimin e emergjencave, ndër të tjera përmes mbështetjes së strategjive, politikave dhe planeve të mbrojtjes civile.

Tabela përmbledhëse e buxhetit

Përbërësit e programit	(Në mijë dollarë amerikanë)		
	Burime të rregullta	Burime të tjera	Gjithsej
Fëmijët e vegjël	550	2 800	3 350
Fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët	750	6 300	7 050
Mbrojtja e fëmijëve	1 850	7 600	9 450
Mjedisi mundësues	950	1 600	2 550
Efektiviteti i programit	150	1 700	1 850
Gjithsej	4 250	20 000	24 250

Programi dhe menaxhimi i rrezikut

52. Ky dokument i programit të vendit shërben si instrumenti parësor për llogaridhënie para Bordit Ekzekutiv në lidhje me harmonizimin e rezultateve dhe burimeve të caktuara për programin. Llogaridhënia e menaxherëve për sa i përket programit të vendit përshkruhet në programin dhe politikat dhe procedurat e organizatës.

53. UNICEF-i do të punojë për forcimin e kapaciteteve dhe të sistemeve të brendshme të partnerëve qeveritarë dhe joqeveritarë, duke u fokusuar në veçanti në një qasje të harmonizuar lidhur me ndihmën ekonomike. Performanca do të monitorohet përmes treguesve të menaxhimit dhe analizat e kryera do të shërbejnë për të bërë përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme në program.

54. Ndër rreziqet që lidhen me rezultatet përfshihen:

(a) Boshllëqe të konsiderueshme në kapacitete që pengojnë realizimin e shërbimeve dhe të drejtave të fëmijëve. UNICEF-i do të investojë për ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve vendorë, për hartimin dhe përcaktimin e kostos së modeleve, dhe do të investojë në menaxhimin e të dhënave;

(b) Për të zbutur pasojat social-ekonomike të KOVID-19 dhe të tërmetit të nëntorit 2019, UNICEF-i, qeveria dhe partnerët e tjerë do të marrin masa për të siguruar që fëmijët në situata të cenueshme dhe familjet e tyre të kenë përparësi në programet e ndërhyrjes, përfshirë edhe përmes ruajtjes së nivelit të mjaftueshëm të shpenzimeve në sektorin social;

(c) Emigrimi jashtë vendit dhe moshimi i popullatës krijojnë vështirësi për shërbimet shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe mirëqenies sociale. UNICEF-i do të investojë më shumë për adoleshentët dhe të rinjtë, duke trajtuar çështje si të nxëniet cilësor, aftësitë për jetën, qasja në aftësitë e nevojshme për shekullin e njëzetënjëtë, dhe shëndeti mendor;

(d) Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian mund të bëjë që fokusi i vendimmarrësve të përqendrohet më me intensitet në aspektet më të dukshme dhe më lehtësisht të arritshme të *acquis* të anëtarësimit, dhe jo në aspektet më të vështira të realizimit të të drejtave të fëmijëve të cenueshëm. UNICEF-i do të hartojë një agjendë më të diversifikuar për avokacinë për mbështetjen e të drejtave të fëmijëve në agjendën e Bashkimit Evropian dhe për mobilizimin e investimeve të tjera.

Monitorimi dhe vlerësimi

55. Korniza e rezultateve dhe e burimeve, e harmonizuar me Kornizën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm e Kombeve të Bashkuara (KBZHQKB), do të bëjë të mundur monitorimin dhe përparimin në kohë drejt rezultateve të planifikuara. Partneri kryesor i programit të vendit për planifikim dhe monitorim është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. UNICEF-i do të intensifikojë gjenerimin dhe analizën e të dhënave mbështetur në një sërë sistemesh statistikore, duke mundësuar kështu monitorimin e të drejtave dhe nevojave të grupeve të ndryshme të fëmijëve dhe adoleshentëve. Kjo do të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të përparimit të bërë dhe të mangësive në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, strategjive kombëtare dhe Objektive për Zhvillim të Qëndrueshëm. Gjatë situatave emergjente do të përdoret Monitorimi i Performancës Humanitare për të siguruar një harmonizim të qartë të rezultateve me Angazhimet Kryesore të UNICEF-it për fëmijët në Veprimet Humanitare.

56. Planifikimi në vijimësi i punës së përbashkët midis Kombeve të Bashkuara dhe qeverisë do të nxisë veprime të mëtejshme. Zbatimi i planit të integruar të monitorimit dhe vlerësimit do të evidentojë nevojën për gjenerim të të dhënave me qëllim përmirësimin e rezultateve dhe pozicionimin strategjik të UNICEF-it. Si pjesë e analizës afatmesme do të kryhet edhe një analizë programatike gjinore.

57. Në Grupin Ndërinstitucional të Kombeve të Bashkuara për Monitorimin dhe Vlerësimin, UNICEF-i do të kontribuojë për monitorimin e arritjeve të KBZHQKB-së. Gjithashtu, UNICEF-i do të mbështesë përpjekjet kombëtare për monitorimin e zbatimit të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

Shtojcë

Korniza e rezultateve dhe burimeve

Shqipëria – Programi i bashkëpunimit të vendit i UNICEF-it, 2022–2026

<p>Konventa për të Drejtat e Fëmijës: Nenet 2, 5, 6, 9, 12, 13, 18–20, 23, 24, 26–29 dhe 40</p> <p>Përparësitë kombëtare: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: 1, 2, 3, 4, 5, 16; Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve</p>
<p>Rezultatet e Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, ku kontribuon UNICEF-i:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Deri në vitin 2026 ka investime të shtuara dhe më të drejta për njerëzit, duke larguar pengesat²⁰ dhe krijuar mundësi për ata që rrezikojnë të mbeten të përjashtuar. – Deri në vitin 2026, qeverisja është me transparente dhe llogaridhënëse, duke mundësuar që njerëzit të gëzojnë shërbime gjithëpërfshirëse cilësore, sundim më të lartë të ligjit dhe qasje në shërbimet e drejtësisë në përputhje me angazhimet që Shqipëria ka në fushën e të drejtave të njeriut. – Deri në vitin 2026, qeverisja me përgjegjshmëri gjinore, forcon barazinë dhe mos-diskriminimin, nxit fuqizimin e grave dhe të drejtat e njeriut, dhe ul dhunën ndaj grave dhe fëmijëve.
<p>Objektivat përkatëse të planit strategjik të UNICEF-it: 1–5</p>

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
Djemtë dhe vajzat më të cenueshëm, si edhe prindërit/ofruesit e kujdesit kërkojnë, kanë akses dhe përdorin shërbime cilësore shëndetësore, parashkollore dhe të zhvillimit të fëmijës.	Përqindja e fëmijëve nën 1 vjeç që kanë bërë vaksinën e fruthit (Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 3.2.1) (Korniza e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, KBZHQB) Pikënisja: 94% (2019)	Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh)- Observatori për Shëndetin Global ²¹ Ministria e Shëndetësisë	1.1 Sistemi i kujdesit shëndetësor ka rritur kapacitetet për të ofruar shërbime të integruara, cilësore, të qëndrueshme financiarisht dhe të barabarta për shëndetin e nënës dhe të foshnjës, të fëmijëve dhe të ushqyerjes, duke u	MSHMS Ministria e financave dhe Ekonomisë (MFE) MASR INSTAT Bashkitë	550	2 800	3 350

²⁰ Përfshirë pengesat politike, legjislative, institucionale, gjeografike, financiare dhe ato të lidhura me normat e sjelles.

²¹ Shih www.who.int/data/gho/data/indicators/indicator-details/GHO/uhc-index-of-service-coverage.

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
	Objektivi: >95% (2026)	dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)	përqendruar në zbulimin e hershëm të problemeve të zhvillimit, ndërhyrjen e hershme dhe ushqyerjen.	Save the Children Bashki te forta Bashkimi Evropian Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) OBSH Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)			
	Përqindja e foshnjave nën 6 muaj të ushqyer vetëm me gji (OZHQ 2.2.1, 2.2.2) (KBZHQKB) Pikënisja: 37% (2019) Objektivi: >40% (2026)	Instituti i Statistikave (INSTAT) MSHMS					
	Fëmijët nën 5 vjeç të identifikuar si të rrezikuar nga zhvillimi me zhvillim të vonuar, apo aftësi të kufizuara të cilët morën shërbime me standarde të ndërhyrjes së hershme nëpërmjet një programi të mbështetur nga UNICEF-i. Pikënisja: 0 (2020) Objektivi: 200 (2026)	UNICEF-i					
	Raporti bruto i regjistrimit në arsimin e hershëm parashkollor (fëmijë 3-6 vjeç) të ndarë sipas gjinisë (OZHQ 4.2.2) (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 79.9; M: 81.9; F: 77.9 Objektivi (2026): Gjithsej: Rritje me 5 pikë përqindjeje (PP)	INSTAT Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë (MASR)	1.2 Deri në vitin 2026, palët e interesuara (përfshirë prindërit dhe ofruesit e përkujdesit) kanë rritur kapacitetet, përmirësuar sjelljen dhe burimet për të kërkuar dhe ofruar shërbime përfshirëse dhe cilësore të arsimit të hershëm parashkollor.				
Djemtë dhe vajzat e moshës shkollore dhe adoleshentë mësojnë,	Rezultati mesatar i Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) për nxënësit e	PISA Shqipëria	2.1 Autoritetet kombëtare dhe vendore kanë forcuar kapacitetet për të krijuar,	MASR MSHMS	750	6 300	7 050

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
<p>marrin aftësi për jetën, kanë akses dhe përdorin shërbime në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe që i përgjigjet nevojave gjinore.</p>	<p>moshës 15-vjeçarë në lexim, matematikë dhe shkencë, të ndarë sipas gjinisë (i përafërt me OZHQ 4.1.1) (KBZHQKB)</p> <p>Pikënisja (2018): <i>Lexim</i> Gjithsej: 405; M: 387; F: 425 <i>Matematikë</i> Gjithsej: 437; M: 435; F: 440 <i>Shkencë</i> Gjithsej: 417; M: 409; F: 425</p> <p>Objektivi (2022): Lexim: 410 Matematikë: 437 Shkencë: 422</p>		<p>zbatuar dhe përshkallëzuar shërbime përfshirëse (cilësore), që i përgjigjen nevojave gjinore, duke inkorporuar novacionin dhe uljen e rrezikut të fatkeqësive.</p>	<p>Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar</p> <p>Bashkimi Evropian</p> <p>Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim Ndërkombëtar</p> <p>Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim</p> <p>Banka Botërore</p> <p>Save the Children</p> <p>World Vision</p> <p>Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë</p> <p>UNFPA</p> <p>OBSH</p> <p>Organizata e Kombeve të Bashkuara për</p>			

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
				Ushqim dhe Bujqësi (FAO) UNHCR			
	Përqindja e adoleshentëve mbi peshë apo obezë, sipas gjinisë Pikënisja (2019): Gjithsej: 27.9; M:30.8; F:24.8 Objektivi (2026): reduktim me 2 pikë përqindjeje	Anketë e FAO-s	2.2 Vajzat dhe djemtë adoleshentë fuqizohen dhe pajisen me njohuri dhe aftësi për ushqyerje të shëndetshme me qëllim që të parandalojnë mbipeshën e obezitetin, dhe për të trajtuar shqetësimet e shëndetit mendor.				
	Përqindja e të rinjve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punë apo trajnim, sipas gjinisë (OZHQ 8.6.1.) (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 26; M: 26; F: 25 Objektivi (2026): Gjithsej: 21.4; M: 21; F: 21	INSTAT	2.3 Vajzat dhe djemtë janë fuqizuar me aftësi të shekullit të njëzetënjëtë, marrin pjesë në platforma qytetare dhe kanë kapacitete më të mëdha për të fuqizuar zërin e tyre.				
Fëmijët më të cenueshëm mbrohen nga varfëria dhe dhuna, kanë akses në drejtësi dhe shërbimet sociale e ato për mbrojtjen e fëmijëve, dhe zhvillohen në një mjedis përkujdesës familjar.	Numri i fëmijëve në kujdes rezidencial në fund të vitit, për 100.000 fëmijë të moshës 0–17 vjeç, sipas gjinisë (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 96.6; M: 98.4; F:94.6 Objektivi (2026): Gjithsej: 50 (M/F)	Shërbimet Sociale Shtetërore INSTAT	3.1 Politikëbërësve dhe sistemeve të përkujdesjes së fëmijëve, mbrojtjes sociale dhe drejtësisë u janë dhënë kapacitete për të përmirësuar politikat, kuadrin ligjor, dhe për të parandaluar ndarjen e fëmijës dhe familjes, si dhe për të mbrojtur të gjitha mundësitë e fëmijëve për t'u	MSHMS Ministria e Drejtësisë (MD) MFE Ministria e Brendshme (MB) INSTAT Bashkitë	1 850	7 600	9 450

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
			rritur në një mjedis përkujdesës familjar.	Avokati i Popullit Sektori privat Save the Children Bashkimi Evropian UNFPA Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave (UN-Women) UNHCR Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara			
	Numri apo përqindja e: (a) familjeve; (b) personave me aftësi të kufizuara; dhe (c) refugjatëve dhe personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme që trajtohen nga sistemi i mbrojtjes sociale (OZHQ 1.3.1) (KBZHQKB) Pikënisja (2020): (a) 66,269 (b) 72,711	MSHMS UNHCR	3.2 Kornizat normative përshtaten për një sistem social të integruar dhe reagues ndaj goditjeve/fatkeqësive, me kapacitet më të fuqishëm për të ofruar ndihmë ekonomike dhe të përkujdesit për djemtë dhe vajzat më të cenueshme si dhe burrat dhe gratë në bashki të caktuara.				

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
	(c) 2.3% Objektivi (2026): (a) 65,000 (b) 70,000 (c) 15%						
	Numri i fëmijëve viktime të veprave penale për 100.000 fëmijë të moshës (0-17 vjeç) në 12 muajt e fundit (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 203.1; F: 106.9; M: 294.8 Objektivi (2026): Gjithsej: Reduktim me 20%	INSTAT MB	3.3: Vendimmarrësit dhe profesionistët e vijës së parë në të gjitha nivelet kanë kapacitete më të forta për të identifikuar në kohë dhe për të ofruar shërbime të integruara dhe të vazhdueshme për mbrojtjen e fëmijëve, që kanë mbijetuar nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi.				
	Përqindja e fëmijëve të moshës 1–14 vjeç që pësuan ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose agresion psikologjik nga prindërit/kujdestarët në muajin e fundit, ndarë sipas gjinisë dhe grup moshës (OZHQ 16.2.1) (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 47.5; M: 49; F: 45 2–4 vjeç: 43 5–9 vjeç: 51 10–14 vjeç: 46 Objektivi (2026): Gjithsej: reduktim me 30 pikë për qindjeje	INSTAT					
	Numri i fëmijëve në paraburgim për 100.000 fëmijë të moshës 14-	MD	3.4 Institucionet e ligjzbatuese dhe ato të				

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
	17 vjeç (OZHQ 16.3.2) (KBZHQKB) Pikënisja (2019): Gjithsej: 12.3; M:24; F: 0 Objektivi (2026): Gjithsej:8	INSTAT	drejtësisë, si dhe profesionistët e përfshirë në proceset ligjore që ndikojnë tek fëmijët, kanë kapacitete dhe instrumente për të trajtuar boshllëqet e mbetura në sistemin e drejtësisë për të miturit, përfshirë kornizën ligjore dhe të politikave, për të përcaktuar se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijës dhe për të bashkëpunuar në ofrimin e shërbimeve të integruara miqësore ndaj fëmijëve.				
Ekziston një mjedis më i favorshëm për politika dhe qeverisje të drejtave të fëmijëve me fokus mbi barazinë, përgjegjshmërinë, dhe ndryshimin e normave sociale dhe gjinore.	Përqindja e shpenzimeve të qeverisë për shërbimet thelbësore si pjesë e gjithë shpenzimeve të qeverisë dhe prodhimit të brendshëm bruto: (a) arsimi; (b) shëndetësia; dhe (c) strehimi i përshtatshëm (OZHQ 1.a.2) (KBZHQKB) Pikënisja (2019): (a) Gjithsej: 11.4%; PPB: 3.3% (b) Gjithsej: 10.5%; PPB: 3% (c) Gjithsej: 1.8%; PPB: 0.05% Objektivi (2026) ^c : (a) Më e lartë se vlera e pikënisjes	INSTAT MFE Enti i Banesave të Qeverisë së Shqipërisë	4.1 Autoritetet kombëtare dhe vendore kanë rritur kapacitetet për të planifikuar, prodhuar, si dhe për të përdorur dhe raportuar me efikasitet mbi buxhetet adekuate të sektorit social, dhe për të mobilizuar burime të brendshme dhe të jashtme për investime të barabarta me fokus fëmijët dhe investime transformuese gjinore.	Zyra e Kryeministrit MFE Avokati i Popullit Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Bashkitë Punonjësit kërkimorë/Studie sit	950	1 600	2 550

^c Në pritje të miratimit të Strategjisë së tretë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022–2030).

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
	(b) Më e lartë se vlera e pikënisjes (c) E barabartë me vlerën e pikënisjes			Organizatrat e shoqërisë civile			
	Kryerja e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë Pikënisja (2020): Jo Objektivi (2026): Po	INSTAT	4.2 Qeveria dhe aktorë të tjerë kanë forcuar kapacitetet për të krijuar dhe përdorur rregullisht të dhëna dhe informacione faktike, veçanërisht për vajzat nga pakicat kombëtare, duke kontribuar në zhvillimin e politikave, monitorimin dhe raportimin që kanë në qendër fëmijët dhe adoleshentët.				
	Përqindja e ankesave të vlefshme të lidhura me fëmijët për të cilat janë ndërmarrë masa nga Avokati i Popullit Pikënisja (2020): 50% Objektivi (2026): rritje me 10 pikë përqindjeje	Avokati i Popullit	4.3 Institucionet e mbikëqyrjes publike kanë përmirësuar kapacitetet për të monitoruar dhe garantuar llogaridhënie lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe shkeljet e të drejtave gjinore,				

Rezultatet e UNICEF-it	Treguesit kyçë të progresit, pikënisjet (P) dhe objektivat (O)	Mënyrat e verifikimit	Produktet indikative të programit të vendit	Partnerët kryesorë, kornizat e partneriteteve	Burimet indikative sipas rezultateve të programit të vendit: burimet e rregullta (BRr), burime të tjera (BT) (në mijë dollarë amerikanë)		
					BRr	BT	Gjithsej
	<p>Përqindja e grave të moshës 20–24 vjeç të martuara ose në bashkëjetesë para moshës 15 vjeçare dhe para moshës 18 vjeçare (OZHQ 5.3.1) (KBZHQKB)</p> <p>Pikënisja (2019): 1.4% (nën 15) 11.8% (nën 18)</p> <p>Objektivi (2026): 1% (nën 15) 11% (nën 18)</p>	INSTAT	<p>për të ofruar masa ndreqëse si dhe për të promovuar ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijës dhe barazinë gjinore, dhe për të kërkuar marrjen e masave për shkeljet e të drejtave.</p> <p>4.4 Qeveria ka forcuar kapacitetet për të përmirësuar e zbatuar kornizën normative që synon promovimin e normave pozitive gjinore dhe eliminimin e praktikave diskriminuese dhe të dëmshme me bazë gjinore të rrënjosura thellë, sidomos në pakicat kombëtare dhe popullatat rurale dhe në marrëdhëniet me to.</p>				
Efikasiteti i programit	Treguesi i performancës në lidhje me realizimin e programit Pikënisja: 0.9 (2020) Objektivi: 0.9–1 (2026)	Llogaritjet e UNICEF-it			245	1 700	1 850
Burime gjithsej					4 250	20 000	24 250